



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT,

BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4517 Prot.

Elbasan, më 06/08 /2026

RELACION

“Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT Albania), në kuadër të projektit IPA-ADRION00107 "ARCA – Platformë e inteligjencës artificiale për parandalimin e rreziqeve natyrore të ndryshimeve klimatike"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", kuadrit rregullator të Programit Interreg VI-B IPA ADRION 2021–2027, si dhe legjislacionit në fuqi për administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, paraqesim për shqyrtim dhe miratim Memorandumin e Mirëkuptimit që synohet të lidhet ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe UBT – Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT Albania), në kuadër të projektit IPA-ADRION00107 "ARCA – Platformë e Inteligjencës Artificiale për Parandalimin e Rreziqeve Natyrore të Ndryshimeve Klimatike", të financuar nga Programi Interreg VI-B IPA ADRION.

Memorandumi synon krijimin e një kuadri bashkëpunimi ndërmjet palëve për përdorimin dhe vijimësinë e infrastrukturës së monitorimit dhe të shërbimeve të bazuara në inteligjencën artificiale, me qëllim parandalimin dhe menaxhimin më të mirë të fatkeqësive natyrore të lidhura me ndryshimet klimatike.

Projekti ARCA synon zhvillimin e një platforme të bazuar në inteligjencën artificiale për mbështetjen e parandalimit dhe menaxhimit të rreziqeve natyrore, veçanërisht zjarreve,

thatësirave dhe stuhive me erë. Projekti financohet nga Programi Interreg VI-B Interreg IPA Adriatik-Jonian (IPA ADRION) dhe zbatohet nga një partneritet transnacional.

• **OBJEKTI DHE QËLLIMI I MEMORANDUMIT**

Memorandumi përcakton një kuadër bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe UBT Albania, i cili shtrihet gjatë periudhës së projektit dhe në periudhën operative pas përfundimit të tij, deri më 30 prill 2032.

Bashkëpunimi do të përfshijë, ndër të tjera:

1. bashkëpunimin institucional në kuadër të projektit ARCA;
2. huazimin pa pagesë të pajisjeve të ofruara nga projekti, kur është e aplikueshme;
3. përdorimin dhe/ose zhvillimin e përbashkët të modeleve të Mësimit Automatik dhe platformave të inteligjencës artificiale;
4. mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore;
5. përcaktimin e proceseve të përpunimit të të dhënave;
6. aksesin në Sistemin e Mbështetjes së Vendimeve (DSS) ARCA;
7. vazhdimësinë e shërbimit të monitorimit për një periudhë prej 5 vitesh pas përfundimit të projektit.

• **DETYRIMET E BASHKISË ELBASAN**

Në cilësinë e Palës së Interesuar, Bashkia Elbasan angazhohet:

1. të lehtësojë aksesin në vendet ku do të instalohen pajisjet e ARCA-s dhe të mbështesë mbrojtjen dhe funksionimin e tyre të përshtatshëm.
2. Të caktojë një person kontakti për koordinimin institucional dhe teknik me Partnerin.
3. Të përdorë në mënyrë aktive shërbimet e ARCA-s dhe të marrë pjesë në takimet periodike të koordinimit.
4. Të japë informacion dhe reagime operative dhe të raportojë çdo problem teknik apo ndërprerje të shërbimit.
5. Të kontribuojë, kur është e mundur, me informacion mjedisor lokal që mund të përdoret për përmirësimin e modeleve të inteligjencës artificiale.
6. Të përdorë shërbimet e ARCA-s në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgjegjësitë institucionale.
7. Të mbajë shërbimin aktiv dhe të vazhdojë të ofrojë të dhëna për periudhën 1 maj 2027 – 30 prill 2032.

- **PËRGJEGJËSITË E PARTNERIT**

UBT Albania, në cilësinë e Partnerit, merr përsipër të:

1. vendosë, operojë dhe mirëmbajë infrastrukturën e monitorimit IoT;
2. menaxhojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mjedisore;
3. sigurojë aksesin në Sistemin e Mbështetjes së Vendimeve ARCA (DSS);
4. ofrojë mbështetje teknike dhe, sipas rastit, të organizojë trajnime;
5. sigurojë, kur është teknikisht e mundur, vazhdimësinë operative të shërbimeve;
6. informojë paraprakisht Bashkinë për mirëmbajtjet e planifikuara ose ndërprerjet e rëndësishme të shërbimit.

- **SHËRBIMET DHE PËRFITIMET PËR BASHKINË ELBASAN**

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, Bashkia Elbasan do të ketë akses pa pagesë në shërbimet ARCA, sipas nivelit të përcaktuar në Shtojcën A.2 të Memorandumit, si informacioni për paralajmërimin e hershëm ndaj rreziqeve natyrore të lidhura me klimën, monitorimi i rreziqeve nga zjarret në pyje, thatësitat dhe stuhitë me erë, përmirësimi i përgatitjes dhe kapaciteteve të reagimit ndaj emergjencave, akses në informacion të përditësuar për monitorimin mjedisor, analiza të gjeneruara nga inteligjenca artificiale, mundësia e përdorimit të mjeteve të raportimit, hartave, të dhënave dhe alarmeve të hershme.

Shtojca A parashikon gjithashtu bashkëpunim për instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen afatgjatë të infrastrukturës së monitorimit ARCA brenda territorit të Bashkisë Elbasan, përfshirë sensorë mjedisorë, mbledhjen e të dhënave, testimin dhe validimin e shërbimeve të inteligjencës artificiale.

- **PAJISJET DHE INFRASTRUKTURA**

Në rastin e pajisjeve të ofruara nga Partneri, ato mbeten pronë e Partnerit. Bashkia Elbasan është përgjegjëse për përdorimin dhe kujdesin e duhur të pajisjeve gjatë periudhës së bashkëpunimit.

- **ASPEKTET FINANCIARE**

Një element i rëndësishëm i Memorandumit është se qasja në shërbimet ARCA ofrohet falas për Bashkinë Elbasan gjatë kohëzgjatjes së Memorandumit, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me shkrim.

Memorandumi parashikon se Bashkia nuk do të jetë financiarisht përgjegjëse për kostot e riparimit, restaurimit apo zëvendësimit të pajisjeve kur dëmtimi vjen si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore, përveç rasteve të sjelljes së qëllimshme, neglizhencës së rëndë ose keqpërdorimit nga ana e Bashkisë. Pajisjet kthehen në fund të periudhës së bashkëpunimit ose sipas procedurave të dakordësuara me shkrim.

Për rrjedhojë, miratimi i këtij Memorandumi, në vetvete, nuk sjell detyrim financiar të drejtpërdrejtë për Bashkinë Elbasan.

- **ORGANIZIMI DHE KOORDINIMI**

Për koordinimin e zbatimit të Memorandumit krijohet një Bord Drejtues, i përbërë nga një përfaqësues i secilës Palë.

Bordi Drejtues do të mbledhet të paktën një herë në vit për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me promovimin, zbatimin dhe koordinimin e aktiviteteve të parashikuara në Memorandum.

- **KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI**

Memorandumi është i vlefshëm nga data e nënshkrimit dhe do të shtrihet deri më 30 prill 2032, përfshirë periudhën operative pas përfundimit të projektit.

Secila Palë mund ta ndërpresë Memorandumin me njoftim paraprak me shkrim prej tre muajsh, ndërsa parashikohen edhe raste të përfundimit të menjëhershëm në rrethana të caktuara, përfshirë shkeljet e pariparueshme, rastet e Forcës Madhore që nuk kapërcehen brenda afatit të përcaktuar, paaftësinë paguese dhe shkeljet e dispozitave të pajtueshmërisë.

- **VLERËSIMI I NEVOJËS PËR MIRATIM**

Bashkëpunimi i parashikuar në Memorandum lidhet drejtpërdrejt me funksionet dhe përgjegjësitë e Bashkisë në fushën e mbrojtjes civile, parandalimit dhe menaxhimit të fatkeqësive, monitorimit të rreziqeve natyrore dhe forcimit të kapaciteteve lokale për reagim ndaj emergjencave.

Përdorimi i teknologjive të inteligjencës artificiale, sensorëve mjedisorë dhe sistemeve të paralajmërimit të hershëm përbën një mundësi për përmirësimin e monitorimit të territorit të Bashkisë Elbasan dhe për rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

Në këtë kuadër, miratimi i Memorandumit vlerësohet i dobishëm për interesin publik vendor, pasi krijon një mekanizëm bashkëpunimi institucional dhe teknik dhe mundëson akses në shërbime monitorimi dhe informacion të bazuar në teknologji moderne, pa krijuar, sipas përmbajtjes së Memorandumit, detyrime financiare të drejtpërdrejta për Bashkinë.


Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe marrjes së aktit të konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan, të vijohen procedurat për nënshkrimin e Memorandumit nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, sipas përcaktimeve të tij.

Konceptoi: Specialist I. Hoxholli
Miratoi: Drejtori MC N. Sinani
Konfirmoi: Dr. PPMCM BPK Sh. Çullhaj



KRYETARI
Gledian Llatja

Me Urdhër e Porosi
ZV/KRYETARI
Asim Sula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____. _____. 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____. _____. 2026

“Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT Albania), në kuadër të projektit IPA-ADRION00107 "ARCA – Platformë e inteligjencës artificiale për parandalimin e rreziqeve natyrore të ndryshimeve klimatike"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile) si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT Albania), në kuadër të projektit IPA-ADRION00107 "ARCA – Platformë e inteligjencës artificiale për parandalimin e rreziqeve natyrore të ndryshimeve klimatike".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile) si edhe Drejtoria e Integritimit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).


SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Elsid Zyma

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Lutfi Lala

Konceptoi: Specialist I. Hoxholli
Pranoi: Drejtori MC N. Sinani
Miratoi: Dr. PPMCMBPk Sh. Çullhaj

Dr. Juridike E. Arapi

Konfirmoi: Zv/Kryetari A.Sula



SHENIME TEKNIKE



MIRATOI:

NENKRYETARI I BASHKISE ELBASAN

Z.ASIM SULA

DREJTORI I D.M.C

ING.NDRIÇIM SINANI

ADRESA: Krraste, Elbasan

Këto sensorë do përdoren për monitorimin dhe zbulimin e hershëm të rreziqeve, si zjarret, përmbytjet dhe situatat e tjera emergjente. Ata do të matin parametra të ndryshëm, si temperatura, prania e tymit, niveli i ujit, lagështia ose lëvizja, dhe dërgojnë sinjale në kohë reale kur konstatojnë vlera jonormale.

RISHI: PERSHKRIMI

NGA: DATA:

FAZA E PROJEKTI:

PROJEKTI ZBATIMIT (ARKITEKTONIK)



BASHKIA ELBASAN

Rruga "Qemal Stafa"

Lagja "Brig 17 Sullmuese"

+35554400152

email: bashkiae@elbasan.gov.al

web: www.elbasan.gov.al

INVESTITOR:

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA:

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Drejtör

Ing.NDRIÇIM SINANI

PROJEKTUES:

Ing.Arian Baku

PROJEKTI:

VENDOSJA E SENSOREVE PER MONITORIMIN DHE PARANDALIMIN E RREZIQEVE

EMERTIMI I FLETES:

PLANVENDOSJA E STRUKTURES

SHKALLA A3:

1:100

PROJEKTI NR:

DATA:

FLETA NR:

NR:

VIZATOI:

Sektor Projektim

A3 / P 01

KONTROLLOI:

Sektor Projektim

RISHIKIMI: